



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
DREJTORIA E FINANCËS
GRUPI I MENAXHIMIT STRATEGJIK

Nr. 2771 Prot.

Patos më 12 / 09 / 2025



Miratohet
Nëpunësi Autorizues
KRYETARI
Fation Duro

PROJEKT-VENDIM

Nr. 54, date 12.09.2025

**MBI MIRATIMIN E PROJEKT DOKUMENTIT TË RISHIKUAR FAZA E DYTË,
TË PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2026-2028.**

KËSHILLIT TË BASHKISË

Në zbatim të shkronjës “dh” të nenit nr. 54, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, nenit 4, 6, 15, dhe 17, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr. 68, datë 27.04.2017, për “Financat e vetëqeverisjes vendore”, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”, udhëzimit nr. 23, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njëjësive të vetëqeverisjes vendore”, udhëzimit nr. 08 datë 28.02.2025 i Ministrisë së Financave “Për përgatitjen e buxhetit afatmesëm vendor 2026-2028”, VKB nr. 10, datë 26.02.2025 “Për vlerësimin, parashkrimin afatmesëm të të ardhurave të bashkisë Patos për vitet 2026-2028”, VKB nr. 14, datë 19.03.2025 “Për miratimin e tavanëve përgatitor të PBA 2026-2028”, VKB nr. 31, datë 30.06.2025 “Mbi miratimin e projekt dokumentit të programit buxhetor afatmesëm vendor 2026-2028 faza e parë”, VKB nr. 40, datë 18.07.2025 “Mbi miratimin e tavanëve përfundimtar të pba 2026-2028, Udhëzimi Plotësues nr. 19, datë 10.07.2025 i Ministrisë së Financave “Për përgatitjen e Programit buxhetor afatmesëm vendor 2026-2028”, GMS pasi ka analizuar kërkesat buxhetore të PBA-së 2026-2028 faza e dytë, i rishikuar paraqet materialin në Këshillin Bashkiak dhe,

KËRKON:

1. Të miratohet projekt dokumenti i Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028 faza e dytë, i rishikuar.
2. Bashkëlidhur projekt-vendimit gjeni projekt dokumentin e PBA-së për periudhën 2026-2028 faza e dytë, i rishikuar dhe tabelat të përgatitura sipas sistemit të menaxhimit buxhetor (smbv.fvv.al) dhe shtojcave të udhëzimit nr. 08, datë 28.02.2025 .

GRUPI I MENAXHIMIT

Sokol Meta

Ina Sauli

Mimoza Shtëmbari

Çajup Refitaj

Ermenita Mici

Fatjon Mici

Juela Shpata

Eneo Xhaferi

Arben Shpërdheja

Andj Kola

Nurkë Hazizaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PATOS
GRUPI I MENAXHIMIT STRATEGJIK

Nr. 2761 Prot.

Patos, më 12/09/2025

Lënda: Relacion mbi miratimin e projekt dokumentit të programit buxhetor afatmesëm faza e dytë, i rishikuar 2026-2028.

KËSHILLIT TË BASHKISË.

Në zbatim të udhëzimit nr. 23, datë 30.07.2018 i Ministrisë të Financave për “Procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njëjësive të vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar, GMS i ngritur me urdhër të titullarit nr. 07, dt. 06.01.2025 vlerësoi dhe përcaktoi parashikimin afatmesëm të të ardhurave të cilat u miratuan me VKB nr. 10 datë, 26.02.2025. Duke u bazuar në udhëzimin nr. 08, datë 28.02.2025 të Ministrisë së Financave “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2026-2028”, dhe në vendimin nr. 10 dt 26.02.2025 “Raportin për vlerësimin dhe parashikimin afatmesëm të të ardhurave të Bashkisë për vitet 2026-2028” GMS analizoi dhe përcaktoi “Tavanet përgatitor të programit buxhetor afatmesëm 2026-2028”, të cilat u miratuan me VKB nr. 14, datë 19.03.2025 dhe u konfirmuan nga Prefekti i Qarkut Fier me shkresën nr. 376/1, datë 26.03.2025, GMS analizoi dhe përcaktoi “Tavanet përfundimtare të programit buxhetor afatmesëm 2026-2028”, të cilat u miratuan me VKB nr. 40, datë 18.07.2025 dhe u konfirmuan nga Prefekti i Qarkut Fier me shkresën nr. 845/1, datë 28.07.2025. Kryetari miratoi udhëzimin plotësues nr. 02, datë 22.07.2025 “Për përgatitjen e buxhetit 2026 dhe programit buxhetor afatmesëm 2026-2028”:

Kopje të versionit 2025 të manualit të përdorimit të sistemit të menaxhimit të buxhetit vendor (smbv).

2. Metodologjinë e re të përgatitjes së PBA 2026-2028 dhe buxhetit 2025.

3. Listën e programeve buxhetore dhe përcaktimin e ekipeve përkatëse të menaxhimit të programeve.

4. Tavanet përgatitore të PBA 2026-2028 për çdo program, për tre vitet e ardhshme buxhetore.

5. Afate të detajuara për GMS dhe ekipet e menaxhimit të programeve (emp) për të përgatitur DPP dhe PSHP.

6. Përgjegjësitë në procesin e përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028.

7. Hapat, vendimmarrjet dhe afatet për përgatitjen e PBA 2026-2028 .

8. Të tjera.

Grupi i menaxhimit strategjik i mbledhur në datë 12.09.2025 vendosi për “Miratimin e projekt dokumentit të programit buxhetor afatmesëm 2026-2028 faza e dytë, i rishikuar i përgatitur sipas sistemit të menaxhimit buxhetor (smbv.fvv.al) dhe shtojcave të udhëzimit nr. 8, datë 28.02.2025, rekomandimeve të Ministrisë së Financave për Bashkinë Patos udhëzimit plotësues nr.19, datë 10.07.2025 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2026-2028”. Ky projekt dokument është hartuar duke përfshirë kërkesat prioritare të listuara në bazë të raportit mbi “Dëgjuesat publike”, nga

1. Të Ardhurat dhe Shpenzimet Publike të Bashkisë Patos në vitet 2026-2028 Faza e Dytë, i Rishikuar

1.1 Të ardhurat e parashikuara të Bashkisë Patos për vitet 2026-2028

Sipas ligjit 139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore”, neni 35/2 bashkitë e ushtrojnë të drejtën e vendosjes së nivelit të taksës , mënyrën e llogaritjes së saj, si dhe mbledhjen e administrimin e tyre brenda kufijve e sipas kritereve të përcaktuara me ligj.

Llogaritja e të ardhurave mbështetet në ligjet në fuqi.

Ecuria e të ardhurave dhe parashikimi për tre vitet të tjera buxhetore

Treguesit janë paraqitur për dy vite para vitit buxhetor, vitin buxhetor, parashikimi për tre vitet e ardhshme.

Të ardhurat nga burimet e veta vendore përfshijnë të ardhura nga taksat, të ardhura nga taksat e ndara, të ardhura nga tarifat, të ardhurat të tjera. Pjesën më të madhe të tyre e përbëjnë të ardhurat nga taksat në masen 65 % për vitin 2026, 65 % për vitin 2027 dhe 65 % për vitin 2028.

Tarifat përbëjnë 35 % të të ardhurave nga burimet e veta për vitin 2026, 35 %, për vitin 2027 dhe 35 % për vitin 2028.

Të ardhurat nga transfertat e pakushtëzuar e përgjithshme dhe sektoriale kanë ardhur me udhëzimin nr. 08, datë 28.02.2025 të Ministrisë së Financave “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2026-2028”.

Të dhënat më poshtë më poshtë paraqesin:

Të Ardhurat e Bashkisë sipas Burimit

Te ardhurat e veta për vitin fakti 2023 është 240,198,000 lekë, fakti 2024 është 286,671,281 lekë, buxheti fillestar 2025 është 312,582,000 lekë , buxheti i pritshëm 2025 është 312,582,000 lekë , plan 2026 është 313,582,000 lekë , plan 2027 është 314,582,000 lekë dhe plan 2028 është 314,582,000 lekë

Trasferta e pakushtëzuar për vitin fakti 2023 është 154,219,000 lekë, fakti 2024 është 225,540,000 lekë , buxheti fillestar 2025 është 228,071,929 lekë , buxheti i pritshëm 2025 është 228,071,929 lekë , plan 2026 është 234,472,353 lekë , plan 2027 është 240,981,756 lekë dhe plan 2028 është 247,331,391 lekë

Trasferta e pakushtëzuar sektoriale për vitin 2023 fakti është 101,520,000 lekë , fakti 2024 është 121,966,000 lekë, buxheti fillestar 2025 është 136,012,302 lekë , buxheti i pritshëm 2025 është 136,012,302 lekë , plan 2026 është 136,012,302 lekë , plan 2027 është 136,012,302 lekë dhe plan 2028 është 136,012,302 lekë

Trasferta e pakushtëzuar sektoriale për vitet 2026-2028 është e njëjtë me vitin 2025.

Të dhënat më poshtë paraqesin burimet e të ardhurave të shpenzimeve:

- Shpenzimet operative për vitin 2026 përbëjnë rreth 19 % të totalit të shpenzimeve.
- Shpenzimet operative për vitin 2027 përbëjnë rreth 19 % të totalit të shpenzimeve.
- Shpenzimet operative për vitin 2028 përbëjnë rreth 19 % të totalit të shpenzimeve.
- Shpenzimet kapitale për vitin 2026 janë rritur me 9 % krahasuar me vitin 2025
- Shpenzimet kapitale për vitin 2027 janë rritur me 2 % krahasuar me vitin 2026
- Shpenzimet kapitale për vitin 2028 janë rritur me 1 % krahasuar me vitin 2027
- Faktorët që kanë ndikuar në rritjen e nivelit të shpenzimeve kapitale për vitet 2026, 2027, 2028 është rezultat i zbatimit me rigorozitet të vizionit dhe qëllimit të Bashkisë.
- Në aspektin fiskal, Bashkia me këtë buxhet synon mbajtjen e pandryshuar të taksave dhe tarifave vendore ose me rritje të lehtë për të përmirësuar cilësinë e shërbimit, si dhe vazhdimin e politikave lehtësuese ose përjashtuese nga pagesa e taksave për kategoritë në nevojë.
- Synon rritjen e nivelit të të ardhurave nga taksat e tarifat vendore duke forcuar strukturat dhe mirëadministrimin duke rritur bazën e taksapaguesve.
- Garanton transparencën në përdorimin e fondeve publike si dhe rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit të menaxhimit të shpenzimeve publike.

a) Shpenzimet e parashikuara për PBA 2026-2028 sipas tavaneve buxhetor është e shpërndarë për çdo vit si më poshtë :

1) Për Vitin 2026

- Shpenzime për paga në vlerën 302,278,354 lekë
- Shpenzime për sigurime në vlerën 55,281,205 lekë
- Shpenzime operative në vlerën 133,258,606 lekë
- Shpenzime për fondin e rezervës, kontigjencës dhe mbrojtjes civile në vlerën 10,390,000 lekë.
- Shpenzime për fondin e veçantë në vlerën 5,964,000 lekë
- Shpenzime për investime në vlerën 176,894,490 lekë
- Total shpenzimet për vitin 2026 janë në vlerën 684,066,655 lekë.**

2) Për vitin 2027

- Shpenzime për paga në vlerën 295,467,271 lekë
- Shpenzime për sigurime në vlerën 55,384,937 lekë
- Shpenzime operative në vlerën 133,488,606 lekë
- Shpenzime për fondin e rezervës, kontigjencës dhe mbrojtjes civile në vlerën 10,390,000 lekë
- Shpenzime për fondin e veçantë në vlerën 5,985,000 lekë
- Shpenzime për investime në vlerën 190,860,244 lekë
- Total shpenzimet për vitin 2027 janë në vlerën 691,576,058 lekë.**

3) Për vitin 2028

- Shpenzime për paga në vlerën 295,467,271 lekë
- Shpenzime për sigurime në vlerën 55,384,937 lekë
- Shpenzime operative në vlerën 133,488,606 lekë
- Shpenzime për fondin e rezervës, kontigjencës dhe mbrojtjes civile në vlerën 10,390,000 lekë
- Shpenzime për fondin e veçantë në vlerën 5,985,000 lekë
- Shpenzime për investime në vlerën 197,209,879 lekë
- Total shpenzimet për vitin 2028 janë në vlerën 697,925,693 lekë.**

	Në këto zona projekti parashikon sistemimin e hapësirave perimetrale të godinave, ndërtim rrugica e trotuare me pllaka, krijimin e hapësirave të gjelbëruara dhe të konturuara, vendosje stola pushimi, kosha të mbetjeve, ndërtim i shkallëve komunikuese në zonat me disnivel të kuotave, vendosje të elementeve të ndricimit dhe krijimi i posteve të parkimit. <i>Rruga "Ahmet Bajo"</i> me gjatësi rreth 225 ml. Gjerësia e karrexhatës së rrugës së rikonstruktuar do të jetë 3.0 m - 3.30 m. <i>Rruga "Thimi Sinjari"</i> me gjatësi 308 ml. Gjerësia e karrexhatës është 3.50 m – 4.0 m. Përfituesit nga ky projekt janë: - Banorët e zonës dhe biznese që ushtrojnë aktivitetin në këtë zonë. Vlera e parashikuar për këtë projekt është: -Në 2025: 40,054,000 lekë -Në 2026: 8,250,892 lekë <u>Vlera totale e Investimit: 48,304,892 lekë</u> Kohëzgjatja e Investimit: 2 Vite
2. Rikonstruksion i blloqeve të banimit në lagjen "1 Maj"	Objekti ndodhet në lagjen "1 Maj", Patos dhe kufizohet nga segmentet e rrugëve kryesore "Unaza", "7 Marsi" dhe "Koli Marku". Blloku ka një sipërfaqe prej rreth 68,450m² dhe sipërfaqja në të cilën do të ndërhyhet është ndarë në 4 zona secila me një sipërfaqe prej: Sip_(zona A) = 21,338 m²; Sip_(zona B) = 13,314 m²; Sip_(zona C) = 19,320m²; Sip_(zona D) = 8,931 m²; Infrastruktura rrugore, kryesisht rrugët e brendshme, kalimet e këmbësorëve mungojnë totalisht në zonë, duke përbërë një rrezik për banorët e lagjës. Aksesueshmëria brenda për brenda bllokut është e vështirë sidomos përgjatë ditëve me reshje të denduara ku mungesa e kanalizimeve përbën një pengesë të madhe për kalimin e mjeteve dhe lëvizjen e banorëve. Punimet që përfshin ky projekt: 1. Rehabilitimin e zonës me të gjithë elementët e nevojshëm infrastrukturorë. 2. Parashikimin e kalimeve për këmbësorët me të gjitha shtresat përkatëse dhe të konturuara me bodura të parafabrikuara. 3. Në pjesët e ndërprerjes së trotuarëve do të parashikohet ndërtimi i panduseve të kalimit në nivel rrugë – trotuar për personat me aftësi të kufizuar. 4. Përcaktimi i sinjalistikës vertikale dhe horizontale. 5. Do të realizohet ndriçimi i zonës sipas parametrave dhe standardeve në fuqi. 6. Sistemimi i ujërave të bardha dhe të zeza. Përfituesit nga ky projekt janë: - Rreth 4000 banorë dhe biznese që ushtrojnë aktivitetin në këtë zonë. Vlera e parashikuar për këtë projekt është: -Në 2025: 16,904,000 lekë, -Në 2026: 80,000,838 lekë, -Në 2027:

	Disa nga problematikat kryesore kanë të bëjnë me dëmtimin e suvatimeve të jashtme, mos shfrytëzimi i të gjitha ambjenteve për shkak të amortizimit të tyre qoftë jashtë ose brenda. Lagështia është një tjetër faktor e cila ka ndikuar dhe në uljen e frekuentimit nga fëmijët për shkak dhe të problematikave shëndetësore që sjell. Gjithashtu vihet re mungesa e sistemit në ngrohje-ventilimit dhe mbrojtjes ndaj zjarrit. Të dhënat teknike: Kati parë: Sip=160m² Kati dytë: Sip=160m² Punimet që përfshin ky projekt: Projekti parashikon ndërhyrjen në të gjithë kompleksitetin e godinës. Janë parashikuar ndërhyrje në disa kategori punimesh pa ndryshuar strukture dhe funksionin. Ky rikonstruksion do të jetë në fasadë dhe i brendshëm. Do të ketë një riorganizim të hapësirave dhe dhomave. Përfituesit nga ky projekt janë: - Bashkia Patos Vlera e parashikuar për këtë projekt është: -Në 2026: 2,208,868 lekë -Në 2027: 10,000,000 lekë -Në 2028: 40,000,000 lekë Vlera totale e Investimit: 52,208,868 lekë
5. Krijimi i Parkut Rekreativ në Lagjen e Re	Objekti në fjalë që do të merret në studim ndodhet në lagjen “e Re”, Patos dhe përbëhet nga 2 zona, përkatësisht zona A dhe Zona B. Zona A kufizohet nga segmentet e rrugëve “Sali Alushi” dhe rruga e “Vreshtit”. Zona B shtrihet përgjatë 2 rrugëve “Qerim Gropa” dhe rruga e “Vreshtit”. Secila nga zonat nga sipërfaqet si më poshtë: <i>Të dhëna teknike:</i> Sip_(zona A)=21,338 m²; Sip_(zona B)=13,314 m²; Në këtë zonë jetojnë rreth 4228 banorë, të cilët përballen vazhdimisht me mungesën e infrastrukturës dhe hapësirave rekreative. Në të gjithë lagjen mungojnë ambiente për fëmijë të cilët mund ti frekuentojnë në kohën e lirë. Infrastruktura rrugore, kryesisht rrugët e brendshme, kalimet e këmbësorëve i janë nënshtruar rehabilitimit total së fundmi duke ofruar banorëve aksesin e munguar prej vitesh. Në këtë lagje është ndërhyrë duke rehabilituar kanalizimet e ujërave të zeza dhe të bardha, sistemin rrugor dhe trotuaret. Gjithashtu rruga është paisur me ndriçim dhe pjesërisht hapësira të gjelbëruara. Problematikë për të gjithë grupmoshat që frekuentojnë dhe jetojnë në këtë lagje është mungesa e hapësirave rekrative. Punimet që përfshin ky projekt: 1. Ndërtimin e një fushe basketbolli në zonën A. 2. Në zonën B të realizohet një kompozim i cili kombinon aktivitete të ndryshme, lojëra në natyrë, zona me gjelbërim, pistë biçikletash, kënde lojrash etj. Përfituesit nga ky projekt janë: - Rreth 4228 banorë dhe biznese që ushtrojnë aktivitetin në këtë zonë. Vlera e parashikuar për këtë projekt është: -Në 2028: 6,000,000 lekë. Vlera totale e Investimit: 6,000,000 lekë

2	Norma e të ardhurave nga taksat vendore ndaj totalit të të ardhurave vendore	Taksat / Të ardhurat vendore	65.0%	65.0%	65.0%
3	Norma e të ardhurave nga tarifat vendore ndaj totalit të të ardhurave vendore	Tarifat vendore/ Të ardhurat vendore	35.0%	35.0%	35.0%
4	Norma e të ardhurave nga burimet e veta ndaj totalit të të ardhurave	Të ardhura nga burimet e veta / Të ardhurat e përgjithshme	46.0%	45.0%	45.0%
5	Norma e shpenzimeve kapitale ndaj totalit të shpenzimeve	Shpenzimet kapitale / Shpenzimet e përgjithshme	26%	28.0%	28.0%
6	Norma e shpenzimeve korrente ndaj shpenzimeve totale	Shpenzime korrente / Totali shpenzimeve	74%	72.0%	72.0%
7	Norma e shpenzimeve të personelit ndaj totalit të shpenzimeve	Shpenzimet e personelit / Shpenzimet e përgjithshme	52.3%	50.70%	50.30%
8	Norma e huamarrjes afatgjatë ndaj totalit të të ardhurave	Huamarrja afatgjatë / Të ardhurat e përgjithshme	0	0	0
9	Norma e huamarrjes afatgjatë ndaj të ardhurave të veta	Huamarrja afatgjatë / Të ardhurat e veta	0	0	0
10	Norma e detyrimeve të prapambetura ndaj totalit të të ardhurave	Detyrime të prapambetura / Të ardhura të përgjithshme	0	0	0
11	Norma e shpenzimeve në politikat sociale ndaj totalit të shpenzimeve	Shpenzimet në politikat sociale / Shpenzimet e përgjithshme	1.20%	1.53%	1.53%

Vlerësimi i rreziqeve financiare e fiskale dhe masat për zvogëlimin e rrezikut janë realizuar nëpërmjet hartimit të regjistrimit të riskut.

Përgjegjës për Planifikimin dhe Monitorimin e Buxhetit

Andi Kola

Drejtoresh e Projekteve dhe Emergjencave Civile

Ermenita Mici

Sekretare e GMS
Drejtoresh Finance
Mimoza Shtëmbari

Kordinatori i GMS
Nënkryetare e Bashkisë
Ina Sauli

NËPUNËSI AUTORIZUES
KRYETARI
Fation Duro